

Odise Kote



...disa poexi...

BIBLIOTEKA

8SH-1
K 93




Tiranë, 1996

8SH-1
K 93

Odise Kote

... disa poezi ...



Tiranë, 1996

... disa poezi ... Odise Kote

Redaktor: Bardhyl Londo

Art grafik: Jolanda Marjanaku

KENGA E GJALLE PER PUNE TE PAKRYERA

*Ç'kam që qaj kështu brenda varrit tim..?
Lotët po m'i kalbin rrasat e qivurit.
Ende paskam brenga, maraze, trishtim,
kallur nëpër eshtra, në ashtin e burrit.*

*S'po i treika mishrat fati i perzishëm.
Balta dhe ujërat po i qajnë damarët.
Punët e pakryera vajtojnë pikëllueshëm,
për të vdekurit dhe të gjallët...*

*Ç'kam që qaj kështu brenda varrit tim...?
Qipariz i muzgut ngulur thellë në ije.*

PREJ ASAJ DITE TE MBRAME...

*...mbi valët e fryra, përplasur shkëmbenjsh
me zhurmën e rrufeve të qiellit.
Kam bërë dashuri me Antigonën,
një grua e pasur me lot dhe qumësht...*

*Prej asaj dite të mbrame...
kam dyshuar në unitetin misterioz të së tèrës,
kukullat e pathyeshme,
dhe gënjeshtrat patriotike të gazetave...*

Prej asaj dite të mbrame!

KUR TE KTHEHESH OR MERGIMTAR I LARGET...

Varkës tënde në shelgjishtet e plakura
i janë thyer rremat.

Kali i bardhi që shtangte monopatet
ka vdekur,
e varrin e kanë mbuluar ferrat.

Të tjera kitara i venë flakën lumi,
për të shuar buzët e përvëluara
të virgjereshave.

Ullinjtë e moçëm janë thinjur ca më tepër
e mikeshëza hollake
është bërë një mendeshë trashaluqe
për kalimtarët.

Kur të kthehesh or mërgimtar i largët,
vetëm nëna e gjorë ri ulur në bregun e pritjes,
duke ndriçuar natën...

VRITENI KETE VETMI VRASESE...

*Myshqeve shtresore dhe
dyerve me rrjeta merimange,
ju jep sisë shurdhëria.*

*Mbi qelqe të thyera
ecën dita...*

*Gjel i vetëm lafshëgjakosur,
molisur mbi hu gardhi,
në mesin e fushës.*

*Mjaullima vajtonjëse macesh,
pjell muzgu,*

*Krrau-krrau,
diku thyhet një tra,
tromaks lakuriqët e përgjumur.*

*Po në shtratin e meitit,
përse s'dëgjohet e qara...?
E qara plasëse?!*

O...o...o..

*O zhurma njerëzore,
vriteni këtë vetmi vrasëse!*

LETER PREJ LARG...

Nëna ime e shtrenjtë, po të shkruaj letër.

*Jam ai që isha, veç hekuri më i butë mes dhëmbëve,
vija- vija këmbët si të kem shkelur hithrat e boiës.
Trafiku më i ngatëruar, zgjat thonjtë e vegjël të frikës,
me maramend e djallëzisht ma kërkon grykën...
S'mashtrohem reklamash e trëndafilash kallp,
me drithëron ende e qara e fëmijës në perëndim të ditës.*

*Pemët tejet të zakonshme, gjithashtu dhe dritat,
dielli si njollë prej jodi ne garzën e pranverës,
me tepri betoni i ndërtesave, ajri më i ndotur.
Vetëm se dritaret tremben, tremben prej nesh
e tërë trumcakët mardhin,
dhe iki me parandjenjën e humbjes në veshin e lodhur.*

*Se dhe era këtu s'fitohet lehtë. Lum i s'lidhet me një Ah',
koha aq më keq s'lidhet me litar si qeni mesnatës.
Kurrë orët e mia s'kanë qenë kaq të kryqëzuara prej heshtjes,
dhe buzët e shpirti s'kanë qenë me të zbrazët.*

*Bëj rrugë të gjatë e të lodhshme. Pambarimisht të gjatë.
I dredhoj policisë. Utopisë së mallkuar për shtetin e butë.
Në trastën e shpinës maraze e therime buke...*

*Trokas dere me derë. Shes krenarinë e grisur.
Shumë e ngushtë shpresa. Theva një gisht duke trokitur,
Asnjëherë s'kam qenë me tepër se tani grabitqar i lekut.
Fle ku mund. Me buburecat e dheut. Miqtë e vetëm.
Duke gërmuar gurin e lashtë thellë tek delli i yllit.*

*Me janë grisur çorapet e holluar kemisha në mengat,
kollitem ngapak ndonëse kam prerë cigaren,
dhe me zotëron papushim zogu i kthimit...*

SKERKA, DHERA TE DHIMBSURA...

*Skerka,
dhera tē dhimbsura,
te brishta, delikate,
pēllēmbēvogla shtrirē nga qielli,
me ngjani me mituraket naziqe.*

*Herë- herë mjegulla
ju mbështjell qafën e holle,
dhe prej frysës tuaj,
dhimbje e lashtë-
sythet bëhen gati flurore,
si prej qelqi.*

*Skerka,
dhera tē dhimbsura,
miturake dielli...*

THUA DURON ZEMRA...?

*... mërmërimë e barit, mugullimë e vesës,
strukjet e aromës, pasqyrat e gjethësi.
Më flasin me zëra të holluar si monopatet,
mi fshikullojnë trishtimet me kulprat hollake.*

*Për ca thanë majhoshe, majhori e egër,
zjarr edhe shemer, dhiareve kam bredhur.
Më kanë lënë në grykë premtimet e zogjive,
të puth shtojzavallen në shushërima krojesh.*

*Manushaqe e prillit në xhep të xhaketës,
lules së dëborës,
kam lindur, kam vdekur-*

*Pse me fergëlloni me heshtjen qortuese,
pse më përvëloni shpirtin me ca prushe,
thua duron zemra borën që të shkrijë...?*

MURGESHA TE VETMUARA NE FUSHE

*Perëndi të vdekura
në kufoma të mermerta,
rrugës tërë pluhur, monoton i guriçka.*

*Qiellit të ç'ngjyrosur nga drita e verës,
të kobshme si uji në kulm të etheve,
zvariten këmbët e gjakosura e të lodhura.*

*Kashitë e verdhë, duhma të verdha,
diçka nga liria e njeriut lakuriq,
mbështijellë me rreze të verdha përvëlönjëse,
digjen zjarr në udhëkryqe iluzionesh-
format që marrin realitetet e fshehta.*

*Murgesha të vetmuara në fushë,
në orët tragjike të mesditës,
me gjurmë të pakundërshtueshme bukurie-
thyer si thepet e një statuje antike,
mbi një tokë të keqe....*

QAJNE SHPIRTERAT E NIMFAVE...

*Qajnë shpirtërat e nimfave,
fatin e gruas së tokës...*

*Arratisur flautëve të mbrëmjes,
përgjuar nga rrökullima gurësh,
bën shenja të padëshifrueshme,
kur hëna
thith qumështin e nënave të përgjumura...*

*Qajnë shpirtërat e nimfave,
fatin e gruas së tokës.
Grua e pashqetësuar përfundin e udhëve-
nga që di të ecë nëpër qiell...*

KA KAQ LAGESHTIRE RRUGEVE TE BOSHATISURA

Ka kaq lagështirë ndaj të gdhirë rrugëve të boshatisura.

*Shetit vetëm era dhe ndonjë kuisje e zgjatur qensh.
Pemët prej larg ngajnjë si kusare që kanë zënë pritë
dhe presin të të hidhen në fyt.*

*Natë e varfër po zhvishet. Berr, berr te ftohit.
Dy fshesare kanë ndezur zjarr. Ngrohin dufet e tyre.
Mbështijellin krahët, mbështijellin zemrat e lodhura.
Rrëfejnë zeulet me një gjuhë të tuprshme,
mizerjet e pazarit, të dollapit, zenkat me burrat.*

*Hera- herës pinë cigar pér të gëlltitur fatin e padrejtë,
në fytyrat gjithë zhubra u vizatohet ngërdheshja.
Afrojnë urët e zjarrit që janë duke mbaruar, mallkojnë,
fshijnë hundët me shamitë e pista, qeshin, heshtin,
me sytë mbërrhyer tek një vrimë e dukshme, e padukshme,
përtej muzgut, ku po zbret drita e agimit,
brenda shtëpisë të një gruaje të re, të vyrtitshme, të bukur,
rrethuar me trëndafila, kyçur me çelës.*

*Ka kaq lagështirë rrugëve të boshatisura.
e një hije pervidhet kangjellave,
zhytet në mjegull...*

KUR NATA GELLTITEJ PREJ SENDEVE...

*Kur nata gëlltitej prej sendeve
me tē gjitha trajtat e saj...*

*Unë shoh agun e ditës si thyen kokën
në gremisje ujvarash tē padukshme,
dheut tē zi.*

*Drita, si tē ish një foshnje,
qan me lotë tē hollë vese
duke i vënë flakën shkretimit.*

*Një plak vetmitar ngjitet malit
gurrerrjepur,
si kalë i dersirë,
duke fshehur shakullimën
e vuajtjeve tē tij...*

Kur nata gëlltitej prej sendeve.

...KAQ MOTE LARGUAR...

*... kaq pranë qëndruar
kaq mote larguar...*

*a nuk e ndjen nga ky i ftohtë,
në stalaktit u shndruamalli.
me shpon si thikë në kraharor,
për ty-
e ikura nga zjarri...*

ME DASHURINE E GRUAS SE PAFAT...

Bie shi në këtë dashuri gruaje të pafat.

*Si lotë pikëlluese sorkadheje bie shi.
Plagosur verbërishi,
kur era shkundte bajamen...*

*Drurët ngjethen nga kjo denese e hajthme,
E pikat e lotit pasqyra të padukshme,
ku krihen kufomat e patretura
të endërrimeve.*

*Bie shi në këtë dashuri gruaje të pafat,
shi kokërmadh...*

PERENDIMI I PROMETEUT...

Lirojeni prangash Prometeun!

Korbat që i kafshuan mishrat ngordhën.

Zhgabat që i hengrën sytë u fyerbuani.

Egërsirat që i shqyen zemrën u çmendën.

Si tunden tani kokallat nëpër erë..?

Vetëm ashtu,

ashu i shtrirë i teri mbi planet.

Sëpuc kerkon të mbrojë

botën nga zjarri...



Ç' E BARDHE E PERZISHME...

*Trishtime të bardha,
pemë të bardha,
të bardha shpatullat,
çarçafët.*

*Gurë të bardhë, arkivole të bardhë,
mushkat, kënaqësitë,
zmalte të bardhë.*

Ç'e bardhë e përzishme.

*Dita gdhin e bardhë,
vdes e bardha,
në këtë akullnajë të tmerrshme..*

Ngjyrat e tjera janë varrosur me heshtjen!

VAJZAT KETE DIMER...

*Vajzat këtë dimër të ngrira si tokë e Janarit,
sillen rrötull parqeve, rrötull dashurive të humbura.
Flokëshprishura. S'besojnë legjendën e Ajkunës,
nuhasin dheun gjurmë pas gjurme si bushtrat.*

*Zbardh' dhyer nga vëtmia, ulur në stolat e vëtmisë,
me sy të zvogëluar, me tesha trishtimi.
I kërkojnë nën rrase hëne duart e tyre të ftohta,
dhe i humbasin tek heshtja që përgjon pas çdo kujtimi.*

*I rigjejnë tek greminat, tek gurrët shtrirë në togje,
në perëndim të kryqëzuara, në nüstere aborti.
S'pranojnë të gjykohen, heretike të fatit,
i ribëjnë me të bukur në arkitekura loti.*

*Përpirë prej cikmës. Shpirtra teje të mardhur,
përjetojnë rënien e tyre, rënien perandorie.
Mbështjellë me përsfirijen e ujshme të murgeshave,
i merr përdore shiu pa i ditur ku i shpie...*

Vajzat këtë dimër...

LIRIKE E FUNDVERES...

*Folëzat e shiut dhe brigjet e lumenjve,
i ka marrë malli i takimit.*

*Po ty, me ç'prefiks të të flas
në Itakën e humbur...?*

*Krifat e kuajve tunden horizontesh
e përshëndetën me violinat e perëndimit...
Duke i lënë në duar
trishtimit më të thellë
dhurata delikate...*

*Të gjithë pëllumbat postarë
fluturojnë drejt teje.
Folezat e shiut dhe brigjet e lumenjëve,
i ka përvëluar malli i takimit.*

NE LIMANIN E LARGET TE DIELAVE...

*Gozhdëve të ndryshkuara të rremave,
ardhur nga përtëj horizontit,
dhe në rrjetën e grisur,
dhe në kripën e vjetër rrëzë shkëmbit,
shkrij trupin dhe faqen e djegur nga malli.*

*Në këtë liman të largët, të dielave,
ku përgjon copëzimi i shpirtit,
nëpër spiranca të haruara,
vijnë edhe ca pulëbardha,
të mjekojnë me jodin e heshtjes,
plagët e ditëve të mia të zbrazura...*

Në limanin e largët të dielave...

PARAJSA E ZHYTUR NE MJEGULL...

*Si një ajzberg fati i këtij qytetit,
zhytur plotësisht në mjegull...*

*Antenat s'duken gjëkundi
për të shuar urinë monotone të informacionit.
Melodi buzuqesh presin reklamat e pista,
vezulluese si fotografi prostituash plot dantella.
Fasada të frikshme mbështjellë me dyer të mbyllura,
me të trishtuara se portet pa anije...*

*Një e qeshur ironike nga rrudhat e vrara të statujave
kris qelqet. Askush se kthen kokën.
Shkretia shumëngjyrëshe s'ka kohë të flejë,
herdhiet e mëdha të bankave ulurijnë
nga fiaskot e bursave, jargasen lypësat.
Asnjë fytyrë e njohur gruaje për të na kujtuar
detin e parqet e zaptuar nga hutimi.
Gjithçka zgyptur plotësisht në mjegull..*

*Pashë vetëm asfaltin mbjellë me kufoma,
që kërkonte të prekte qiellin...*

KOVA E PUSIT TE VJETER...

*'Memezonja e quante
kapelja e verës.*

*Tingulli i saj,
piqte qershitë e para
dhe lagte majat e qiparizave
që shponin qiellin e zbehtë.*

*Tani rri braktisur,
brere, shpuar, ndryshkur,
në tokën e pluhurosur nga dielli.*

*Pret e pret
erën,
gjyshen e shiut,
të shpjerë larg,
të shuajë zjarret
që i krijon me klithmat e veta.*

*Kova e vjetër
e pusit të kujtimeve..*

PENGU I DEBIMIT...

*.. kjo pingerimë e lehtë zogu,
shkruar mbi gjethë e krahë lejlekësh,
ardhur prej larg në strehën e vjetër,
nga ujërat e kristalta e të dremitura,
troket në qelqet e kujtesës.*

*... kreh vajzërinë në pasyrat e vesës,
gërshtetin e gjatë, të kaftë,
që ledhaton ëmbël lëkurën e re të pemëve,
petalet e luledaleve,
dhe luan me dihatjet e ëndrrës,
pulitjet e syrit,
sa mend me merr frymën e zgjimit.*

*ka nisur të digjet
nga zjarri i prillit.*

Pengu i dëbimit...

STATUJA QE NE PRANGA ME MBANI...

*Më thërret prej viseve të fëmijërisë,
Oqeani....*

*Male të shkreta,
kodra të rrudhosura,
mehallë e mjegullt,
në këtë kohë dhe atë që shkoi,
duartrokasin veç vetëveten.*

*Megjithatë ato mund të kapërcehen.
Por statujat,
ah statujat janë më të tmershme.*

*Statuja për njeriun që digjet në zjarr,
për maskat, mendëshat e pushteteve,
për fytyrat e thella dhe pluhurin,
për xhamat e trubullt të qyteteve,
për heshtjen e madhe, për flakën,
për të varurin në urën e kalbur,
statujë dhe për një shaka idiote...*

*Oh statuja!
Statuja që në pranga më mbani,
u mbytshi një ditë tek Oqeani!*

QYTET I VESHUR ME PETKA KARNAVALESH...

*Qytet i veshur me petka karnavalesh,
nën shiun mesdhetar,
zgjon nga gjumi pëllumbat
që flenë nëpër thekët e pelerinës së detit.
Dehur zhurmshëm nga tymi pijeve të nxehtha,
në taverna portesh ku kacafyten hamejtitë.*

*Pelegrinët e haruar
në muzgun e botës gjejnë strehë,
duke mbillaçitur një grumbull njollash të çrregullta,
dergjur në boshllék.
Maskat e bukurisë sarhoshe,
fshihen pa prehje nga lotët që ndezin fenere
e hedhin nëpër pellgje
zjarre të lahtarshëm.*

*Qytet me pëllumba,
i veshur me petka karnavalesh,
duke pasur frikë nga fytyra e të vdekurve...*

NENA FSHIN KEPUCET E HIJES...

*Vulosim gurmazin me nga një breg qe mos qajmë.
Thyejmë dhembët e klithma del serish si ulërimë ujku,
Sytë tanë u thanë.
U thanë.
U bënë dy gozhda të trasha.
Atje tej era me këmbët e prera.
Nëna fshin këpucët e hijes me gjurmën e përgjërimit.*

*Po pse ike kaq larg...?
Kaq larg...*

*Pështyma tretet në gjuhën boshe.
Njolla e lagështirës në murin e dhomës zmadhohet.
Në pantallonat e varura, xhepave të zbrazura,
takoj pushin e ngrohtë të duarve të ikura.*

*Godasim me shkelm orët.
Hëna thyen kokën nëpër hatulla.
O derëzeza... kuja e hollë kris trarët e çatisë,
dhe qelqet e akullta.
Cili shpend na e dërgon këtë kuje?
Gjithë natën qante jashtë dritareve,
duke përtypur kocka,
gjithë natën...*

IKJA E MUHAXHIREVE TE BRENGOSUR...

*Ikin muhaxhirët e brengosur,
prej përrenje të zhveshur nga era,
nën një krokame korbash,
që gremiset bërrylave të shkëmbinjve.*

*Oi, oi...
ulërasin puset e tharë,
trungjet e zhuritur, gurët
dhe bari i egër.*

*Tek një tjetër qìell,
në një muzg tjetër.*

*Ikin karvane - karvane,
lecka- lecka,
me kokat kthyer pas,
pluhurosur nga fati i zi.
I fundit, një muhaxhir
mban një thes me kocka të freskëta
mbi kurriz...*

VARGJE TE THYERA...

*Pam-pam, pam-pam.
Një e çmendur luan me topth leshi,
mbi çatinë e kujës.*

*Kërcen topthi, krijon vrenduj ere
si zogj të vrarë.
Orët priten. Akrepat ngulen
në mishin e dhjamosur,
si heshta të frikës.*

*Poshtë,
lengimtarët qeshin,
shkrihen se qeshuri.
Dhe varka ikën në via rrreshqitëse
ujrave që rrjedhin tek plagët e ditës. .*

*Pam-pam, pam-pam.
E çmendura në kulm të eksitimit,
pozon Top-show për mediat dhe ekranet.
Lengimtarët serish qeshin,
pa e kuptuar,
se ajo luan me lemshin e dheut,
mbi çatinë e kujës qyqare...*

KU KA IKUR ALI PODRIMJA?...

E dashura tundon:

-Mos me puth pa me treguar për Aliun...

Ka ikur!

Ka ikur andej nga do të zgjohet dielli.

Pas të qarave të Lumit...

*Pas statujave,
pikëllimit të ëndrrës,
krushk i dasmës ilire.*

*Erdh' pranvera
fryhen lumenjtë...*

*Mbi ç'qiej fryma e tij
rrokullis dhimbjen tragjike?*

*Fatin fshehur Evropës
ka shkuar ti rrëmbejë-*

*-Puthmë,
dhe tregomë sërish për Aliun e jetës...*

*Dhe sa shekuj
s'do të na zërë gjumi..
Sa shekuj?*

PAS NJEMIJE VJETESH DO TE VIJE

*Qeni i plakur lepin këmbët
pis, gjithë dremçka.
Përtyeshëm një mace vërtitet
me tuije ca pula të trembura.*

*Mullarit i ka ngelur vetëm
dru i kalbur si dordolec.
E bari i zverdhur, përbaltur
s'arrin të japë imazhe lëndine.*

*Një plak i çuditshëm vërtitet
nëpër gjysma tinguish të vrarë.
Më pas një e kollitur e thatë
si krisma e një dërrase kur thyhet.*

*Pas njëmijë vjetësh eremiti,
do të puthë hithrat e harimit
në pragun e shtëpisë...*

RROKULLISESH MBI BAR...

*Kur ti rrokullisesh mbi bar...
si një mollë e kuqe.
Mollë e kuqe me thuaj
sa buzë të kanë lënë?...*

**...SHUME ME BRENGOS POEZIA
E PAIMITUESHME...**

*...ç'muzikë bën mbi setra, kokëpingulthi,
duke me marrë me vete në jehonat e trishta
të rr Ethanave, historive me gjak të ngrohtë
dhe hove dhe përthyerje,
pellgut që shan një këpucë e bredh kuturu...*

*...sa fort tingëlloka, si dajre ciganeje
dhe vëشتirë ta kthesh pas ne plepat e bregut
që rendin turavrap pas baticës së re
plagosur në buzët e kuqe...*

*... sa shumë me brendos poezia e paimitueshme,
e kësaj vajze indiferente lagur në shi...*

*Dy sy,
katër,
tetë,
sërish dy sy,
që nuk depërtuan dot,
pas murit të bardhë absurd
të një pylli vjeshtak,
ku hijet e drurëve pikëllonin
të zhjtura mbi liqen.*

*Më kujtohet mjaft qartë,
se të dy mendonim të njëjtën gjë,
nisur nga trajktore rrugësh të ndryshme,
për të mbërritur aty,
në realitetin e thjeshtë të një puthjeje...*

Por vetëm dy sy nuk mjaftojnë...

E MARRIN PERDORE QERSHITE...

*Ende pa ardhur në jetë,
e thërrasim me emër...*

*Ai fle në puthjen tonë,
duke i krehur flokët një ëndrre.*

Me fryshtës marrjen në fyejt e vjeshtës.

*Nën këmishë ka veshur shelgjet dhe lumin,
nimfat ja ndjellin e përzënë gjumin.
Me doçkën shtrirë si ngrëtësia,
në rrënje të puplës së pëllumbit.*

Djalin tonë e kanë marrë përdore qershitë...

STREHEZA E BRAKTISUR...

*Strehëz e drunjitë,
ngrënë prej tingujve të zogjve,
prej shiut,
heshtjes.
Sharrave të vogla të yjeve të verës.*

Klithm' e përbajtur pas derës!

Ku fshihet fëmijëria në kalim të erës...?

*Buka pret eremirë,
gjella pret e ngrohtë.
E ruan mbi tryezën e drekës malli,
mos fitohet..*

*Ditë të tjera me duar të flakura.
Një hënë prej breshëri e lashtë.*

*Zgjohet me çarçafët e vesës,
dielli përgjon nga vrima e çelësit...*

KALOI PIKELLIMI I NDARJES...

*Në rrugicën e boshatisur të mesnatës,
kaloi pikellimi i ndarjes, si një plak i verbër.
Shkop i drunjtë trokiti mbi ca shenja fatale,
sipërfaqes së heshtjes.*

*Shenja fatale,
shenjime ndarjesh të dhimbshme e tragjike,
brinjëve lakuriqe të botës.
Për të na treguar se në buzëqeshjen etike-
vrima- s'është një hollësi e vogël..*

*Kaloi pikellim i ndarjes, si një plak i verbër,
në rrugicën e boshatisur të mesnatës.*

NE FYTYREN E HENES VERORE...

*Mu verbofshin sytë-
portat e mia magjike!*

*Shkëmbinjtë kridhnin ujrave
ijet e tyre lakuriqe,
kur pikat e ujit dridheshin të palëvizshme
qepur pas rreinave të barkës.*

*Ishte e brishtë si një kallam uji,
e mitur si qumështi i barit,
në atë heshtje aq të thellë
sa dëgjohej dhe loti kur binte...*

*Atje në breg,
vizatuar në fytyrën e hënës verore,
forma delikate e një shkureje,
si flokë hedhur supeve për t'u tharë...*

IKEN DALLANDYSHET E SHEN MERISE...

*Ikën dallandyshet nga vjeshta e gruas,
e gruas me sytë liqene të kaltër.*

*Ikën dallandyshet e Shën Mërisë,
në lirishta kujtimesh të largët.*

*Erdhi vetmia me fustanin gjith' rrudha,
rrudha alkoli për të ngrohur gjakun.*

*Erdhi vetmia mbështjellë me qefin,.
në vjeshtën me llërët e ftohië e të lagur.*

*U gris fotografia e fatit në një cep,
në një cep të tualetit të hollë femëror.*

*U gris fotografia e ditës së tejdukshme,
e mbi dy gjinj të lodhur dielli perëndon.*

*Ikën dallëndyshet nga vjeshta e gruas,
e gruas me sytë liqene të kaltër.*

*Ikën dallandyshet e Shën Mërisë,
në lirishta kujtimesh të largët...*

BABAI...

*Ai zbret përditë nga një pemë mitologjike,
duke ju fryrë fyejeve të gjethive,
mes freskisë mengjezore,
nën një ritëm këmbanash që bien papushim.*

*Hollak, sykaltër.
Herë shuhet si një gacë e zezë,
e herë ndriçohet si sfinks...*

*E kollitura e thatë, e thatë,
me e heshtur se vetë heshtja,
nuk i tremb bilbilat e verës,
as trumcakët e dhjetorit.*

*Dhe sepse me ngjan me Priamin,
që shkon të marrë kufomën e Hektorit...*

KENGE E SAPONISUR...

E humba të dashurën time!

Qani, qani ju korba...

Ishte murgeshe.

Ishte si një murgeshë agoiste.

*Tani vështrimi im ri plagosur,
në petalet e ftohta të prillit...*

TRE KUAJ...

*Tre kuaj bredhin në një livadh të blertë,
tre kuaj.*

*Njeri me pulla të bardha trupit,
bishtzi,
krifekuq e larushan dy të tjerët.*

*Tre kuaj krejt të bukur,
në një perëndim të tejdukshëm marsi.*

*Sovranë të lëvizjes,
me një tundje të lehtë të vitheve,
kundërmojnë erë bari rrafshinash.*

*Krejtësisht të pavarur,
tre finoshet,
ia bëjnë me sy lirisë ekzistente.*

*Matanë në kasollen e rrënuar,
samarxhiu i vjetër,
përgatit skllavërinë e tyre...*

SOT E DIEL...

*Violinat e së shtunës,
delikate gjer në pikëllim,
me ftuan me syrin e mëllënjës në lëvizje,
të ik në fshat.*

*Eja.
Mbi gjoks adoleshntesh varen
shelgjet lotues...
e lumit vetëdigjen muzgje të artë.*

*Pulitjet e sythave të dëborës
(lule gjithsesie)
shpleksin flokët e dëshirave të erës.
gjurmët e vjetra, pengjet përvëlues
piqen si frytat e verës.*

*Vrap i endrrës së florinjtë,
gurgulloi si uji nëndheshëm i lëndinës.*

*Sot e diel. Nuk shkoj në fshat.
Kam frikë se më vjedhin makinën.*

PERRALLE PER TE RRITUR...

Macja ime vdiq sot.

*Mikeshat e saj mjaullinë
mbi agoninë e shkretisë,
duke u falur për shtatë shpirtërat e qiellit...*

*Mbi grykët e uritura të tyre
era shpërndau një tufan ngjethës,
që grisi cipën e hollë
të dhimbjes e mjerimit.
Kur mbaruan se vajtuari
ato ishin ulkonja...*

*Macja ime vdiq sot,
me sy të hapur si të një virgjëreshe...*

... DEBUAR NE ETYD ENGJELLI...

*...Zheg i qashtër, këmbanë e mbasdites me dhunë,
deformon përfytyrimin, flutura të trullosura,
një fëmijë me shkop gjuan përvëlimin që zurret
në gurmaze gjinkallash mafreske pluhuri, hija
tejiërkund, qipariza vertikale,
bari që s'është bar, rrënje rezistente,
rrezet e pjerrëta të diellit që do t'më qullin,
fryma më e rrezikshme se shkrepsha, pastaj kujtesa
e dëbuar në një etyd engjelli dhe cigarja e pashuar
në buzët e ditës.*

*Koka e prerë,
rrokullisur në argjilin e tokës,
një fërshëllimë e përgjumur ringjall vajtimin.*

...pulëbardhat pelegrinonin perëndimin.

KITARA

*Vëreni si shkëlqen limfa e gjetheve të rëna,
si formohen zogj nga pëshpëritjet e barit.
Hapat e vdekur dihasin trungjeve të prera,
harmonia mrekullohet në ekstazë zjarri.*

*Shamitë me gjurma buzëqesh ndrijnë
si diej të vegjël,
mbi gjymtyrë pemësh që ngrihen ngadalë.
Avujt maramenden prej dheut ngjyrë blertë,
duke e fshehur fytërën e një hëne të bardhë.*

*A nuk e shihni pyllin e larë mbi atëbreg,
si u ngrit prej ujrave plot sytha te lumi.
Po tingullin, tingullin e tij mëkatar,
që vjen t'ju rizgjojë nga gjumi?!...*

BOLERO...

Bam.

Bam.

*Pas ritmit tē takave fluturuese,
tē vdekurit braktisen varret e nisën tē kércejnē.*

*Një grua lakuriqe, fantazmë qiejsh,
vraponte si e çendur, ndjekur nga demi i muzgut.
Pas saj, mijëra balerina, pika shiu e loti
vizatojnë mbi gjethe pemësh gjurmë ekstaze.*

*Lengu seksual derdhet në ylbere
dhe cepa fundesh digjen si pyje tē pashkelura,
në harmoninë e zjarrit...*

*Këmbanat binin tē këpusnin belin e boleros,
e lumenjtië thahen nga etja e puthjeve tē zhuritura.*

Bam, bam, bam.

*Pas ritmit tē takave fluturuese,
edhe toka rrotullohet rrëth diellit...*

Bam bolero!

ESHTË E MREKULLUESHME TE DHUROSH KARAFILA...

*Eshtë e mrekullueshme të dhurosh karafila
për San Valentinton,
në Athinë, ku nga të gjitha rrugët zbresin perëndeshat.*

*Lëvizjet e heshtura zgjohen nga britmat dhe dritat
shumëngjyrëshe,
duke vizatuar në qelqet e vitrinave një fytyrë shprese.*

*Poshtë mureve të suvatuara, letrat anonime të dashurisë
fërgëllojnë, duke plasaritur muzgun e harrimit.*

*Një typës në mes të trafikut mban në dorë tabelë të çuditshme:
"Grek, ke genë me human kur ishte më i varfér..."*

*Një shi i mjerë, mbushur me tingujt e kitarave të thyera
qosheve të pijetoreve,
nuk më pengon të dëgjoj këngët- psherëtima që rrefugjatët
i këndoijnë nëpër endra...*

*Jashtë. Jashtë natës së magjishme të puthjeve të ndezura,
pemët e lagura të trotuareve, të dashurat e tyre të vetme-*

*Eshië e mrekullueshme të dhurosh karafila për San Valentinton,
dhe po aq e dhimbshme të urresh Athinën për shkak të tij...*

QAME DERI BREND A KOCKAVE TONA..

*Shtrirë mbi shtrat të drunjtë,
me një dritëz rrebele hëne..*

...

*Si ikën korbat,
era e shurdhët
që përtonte t'u binte kambanave...*

*Unë dhe nata plakë
çift
vdekjezhuritur.
U ulëm dhe qamë
deri brenda kockave tonë..*

Përbajtja

<i>KENGA E GJALLE PER PUNE TE PAKRYERA</i>	3
<i>PREJ ASAJ DITE TE MBRAME.....</i>	4
<i>KUR TE KTHEHESH OR MERGIMTAR I LARGET.....</i>	5
<i>VRITENI KETE VETMI VRASESE.....</i>	6
<i>LETER PREJ LARG.....</i>	7
<i>SKERKA, DHERA TE DHIMBSURA.....</i>	9
<i>THUA DURON ZEMRA...?</i>	10
<i>MURGESHA TE VETMUARA NE FUSHE.....</i>	11
<i>QAJNE SHPIRTERAT E NIMFAVE.....</i>	12
<i>KA KAQ LAGESHTIRE RRUGEVE TE BOSHATISURA</i>	13
<i>KUR NATA GELLTITEJ PREJ SENDEVE.....</i>	14
<i>...KAQ MOTE LARGUAR.....</i>	15
<i>ME DASHURINE E GRUAS SE PAFAT.....</i>	16
<i>PERENDIMI I PROMETEUT.....</i>	17
<i>Ç' E BARDHE E PERZHISHME.....</i>	18
<i>VAJZAT KETE DIMER.....</i>	19
<i>LIRIKE E FUNDVERES.....</i>	20
<i>NE LIMANIN E LARGET TE DIELAVE.....</i>	21
<i>PARAJSA E ZHYTUR NE MJEGULL.....</i>	22
<i>KOVA E PUSIT TE VJETER.....</i>	23
<i>PENGU I DEBIMIT.....</i>	24
<i>STATUJA QE NE PRANGA ME MBANI.....</i>	25
<i>QYTET I VESHUR ME PETKA KARNAVALESH.....</i>	26

<i>NENA FSHIN KEPUCET E HIJES.....</i>	27
<i>IKJA E MUHAXHIREVE TE BRENGOSUR.....</i>	28
<i>VARGJE TE THYERA.....</i>	29
<i>KU KA IKUR ALI PODRIMJA?....</i>	30
<i>PAS NJEMIJE VJETESH DO TE VIJE.....</i>	31
<i>RROKULLISESH MBI BAR.....</i>	32
<i>...SHUME ME BRENGOS POEZIA E PAIMITUESHME.....</i>	33
.....	34
<i>E MARRIN PERDORE QERSHITE.....</i>	35
<i>STREHEZA E BRAKTISUR.....</i>	36
<i>KALOI PIKELLIMI I NDARJES.....</i>	37
<i>NE FYTYREN E HENES VERORE.....</i>	38
<i>IKEN DALLANDYSHET E SHEN MERISE.....</i>	39
<i>BABAI.....</i>	40
<i>KENGË E SAPONISUR.....</i>	41
<i>TRE KUAJ.....</i>	42
<i>SOT E DIEL.....</i>	43
<i>PERRALLE PER TE RRITUR.....</i>	44
<i>... DEBUAR NE ETYD ENGJELLI.....</i>	45
<i>KITARA</i>	46
<i>BOLERO.....</i>	47
<i>ESHTE E MREKULLUESHME TE DHUROSH KARAFILA.....</i>	48
<i>QAME DERI BRENDA KOCKAVE TONA.....</i>	49



Odise Kote është lindur më 13 gusht 1960 në qytetin e Gjirokastrës. Ka kryer studimet e larta në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në vitin 1983 si dhe fakultetin Gjuhë - Letërsi në vitin 1991. Aktualisht punon kryeredaktor i Radio - Gjirokastra. Pas vëllimit me poezi "Orët e mëngjezit" botuar më 1989, ky është vëllimi i dytë me poezi.

Kënga e gjallë për punë të pakryera.
Mungesha të vetmuara në fushë.
Parajsë e zhptyr në mjegull.
Ku ka ikur Ali Podrimja?
Rrokullisesh mbi ban.
Vangje të thyera.
Sot, e diel.
Bolero.

Babai.
Tre kuaj.
Letër prej larg.
Kaq mote languan.
Pernalla për të rrnitur.
Qajnë shpirtërat e nimfave.
Kur nata gjëltitej prej sendeve.
Qytet i veshur me petka karnavalesh.
Etj.